

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Vit i ri shkollor me problematika të vjetra', Xhixho: Shqipëria humbi rreth 5,900 nxënës, ose rreth 4%
ADRESA	https://piranjat.al/politike/vit-i-ri-shkollor-me-problematika-te-vjetra-xhixho-shqiperi-a-humbi-rret-i104012
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 10:26:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 10:25:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a4ebbcd64c48945e5de9967a5a8173ecd81c7274082d4ad7ab9df107f6592d46
TEKSTI	581f6c7ed983b935c696852fb9d5ee91982bc1e794c026ddfd6146b9b11248ce
PAMJA	0299df9008f16b60978b471d8f641b0969fc42b9f680aaa4c73bb66744d27eb1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ff5df495aa82875c699c97acf3a29d1872b16167630122485235c05792e2c40c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	fa5011856be057622e11e3b7b9503371417a521d23e6e858a13f19aee6db6a1d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ff5df495aa82875c699c97acf3a29d1872b16167630122485235c05792e2c40c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **kunder** qeverisë, kërkohet radhe. Nderkohë protesta e **te** komisariati nga sheshi Skënderbej, rruga e **në Prishtinë** paralajmëron paralajmëruar qytetarët për protesta të **së GJKKO** për mediat, depozituar në Gjykatën Kushtetuese **regjistruan** edhe bashkia Vlorë- **ne ZVA**

[POLITIKE](#)

‘Vit i ri shkollor me problematika të vjetra’, Xhixho: Shqipëria humbi rreth 5,900 nxënës, ose rreth 4%

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 12:25



Deputetja e PL, Erisa Xhixho tekta ka uruar nxënësit dhe mësuesit për vitin e ri shkollor, u shpreh se ky vit nis sërish me problematika të vjetra,

Në deklaratën për media, Xhixho tha se Shqipëria humbi rreth 5,900 nxënës, ose rreth 4% të nxënësve.

Sipas saj, rënia progresive e numrit të nxënësve gjatë dekadës së fundit i ka boshatisur shkollat, sidomos ato të periferive dhe fshatrave, me një humbje të më shumë se 112 mijë nxënësve në 10 vjet.

‘Pas një dekade pushtet, shqiptarët nuk kanë më nevojë për slogane, inaugurime fasadash apo projekte të emërtuara në anglisht. Kanë nevojë për shkolla, mësues, kapacitete, kurrikula që afrohen tregut të punës, siguri dhe mbi të gjitha, për një arsim që u jep fëmijëve të tyre dijen dhe mundësinë për të ardhmen’, u shpreh ndër të tjera Xhixho.

Deklarata e deputetes së PL, Erisa Xhixho

Dua ta nis këtë komunikim me një urim për të gjithë nxënësit e sistemit parauniversitar që fillojnë vitin e ri shkollor. Një urim të veçantë për mijëra vogëlushë që ulen për herë të parë në bankat e shkollës dhe një vlerësim e mirënjohje për mijëra mësues që nisin një vit të ri sfidash.

Por ky vit i ri shkollor nis me problematikat e vjetra.

E re është vetëm propaganda e Ministrisë së Arsimit.

Një tjetër vit me tkurrje të numrit të nxënësve, me shkolla që mbyllen, klasa të bashkuara dhe mësim me 2 turne. Në krahasim me vitin e kaluar kemi humbur rreth 5,900 nxënës, ose rreth 4%.

Ndërsa në fshatra numri i pamjaftueshëm i nxënësve mbyll shkolla dhe lë pa punë mësues, në Tiranë nuk ka shkolla të mjaftueshme për fëmijët.

Janë 146 shkolla publike që nuk e përballojnë dot kapacitetin e nxënësve. Zona e Astirit me 70 mije banorë vijon sërish pa një shkollë për fëmijët, të cilët edhe këtë vit janë të detyruar të

supermarketin nepër shkollat e fëmijëve të tjerë të Tiranës. Për pasojë, prindërit e tyre numërojnë orë të tera në trafik dhe paguajnë me shume për shkak të natës që ka shkollat në 230 tekë për t'u...

Vetëm dita e parë e shkollës për një fëmijë i kushton rreth 340 mijë lek të vjetra që nga canta, veshmbathjet , librat,fletoret etj.. për një fëmijë, imagjononi për 2 fëmijë apo më shumë fëmijë se çfarë kosto e papërballueshme është arsimimi sot për familjet.

Në këtë krizë ekonomike qeveria nuk merr asnjë masë për ti ardhur në ndihmë familjeve me pagat më të ulta në rajon .

Rasti i shkollës “Edith Durham” në Tiranë është një tjetër shembull i premtimit të pamjaftuar. 4.9 milionë euro investim, por godina e re “Edith Durham” ka më pak klasa se shkolla e vjetër. Nga 45 klasa që kishte më parë, godina e re, pasi detyroi qindra fëmijë të mësonin me turne për dy vjet, sot ka vetëm 40 klasa.

Kjo do të thotë të prishësh një shkollë për të ndërtuar një më të vogël që vetem ne shqiperi mund te ndodhe.

Si pasojë, një pjesë e nxënësve do të detyrohen të largohen në shkolla të tjera ose do rrisin numrin enxenesve nenklasat ekzistuse për shkak të mungesës së kapaciteteve.

Premtimit se do t'i jepej fund mësimit me turne është mashtrimi prej vitesh që vazhdon.

Një tjetër aferë me të cilën përballen nxënësit këtë vit shkollor janë kamerat inteligjente.

Në 20 ndër shkollat më të frekuantuara në Tiranë dhe Kamëz kanë nisur të instalohej rreth 600 kamera në kuadër të projektit “Smart City” një aferë tjetër korruptive. Pa asnjë konsultim paraprak me prindërit dhe pa një vlerësim specifik të ndikimit të këtij projekti në mbrojtjen e të dhënave personale.

Asnjë informacion i qartë për të dhënat që sistemi mund të mbledhë, mënyrën se si përpunohen dhe ruhen ato, kush mund të ketë akses në to dhe nëse ekzistojnë mekanizma të mjaftueshëm e të pavarur për mbikëqyrjen e kësaj teknologjie.

E gjitha kjo ndodh në një vend ku siguria e të dhënave nuk ka qenë kurrë e garantuar dhe ku, sa herë të dhënat e qytetarëve dalin në shesh, përgjigjja e qeverisë është e gatshme, fajin e kanë iraniantët.

Edhe ky vit shkollor nis me më pak nxënës se viti i kaluar. Rënia progresive e numrit të nxënësve gjatë dekadës së fundit i ka boshatisur shkollat, sidomos ato të periferive dhe fshatrave. Kemi humbur më shumë se 112 mijë nxënës në 10 vjet.

Por bashkë me nxënësit kemi humbur edhe cilësinë në arsim.

Rezultatet e fundit të testeve PISA treguan se arsimi ka dështuar. E megjithatë, pavarësisht manipulimeve të qeverisë me shkollat që kanë marrë pjesë në testim dhe numrin e papërmbytur të tyre, Shqipëria mbetet sërish në klasë.

Analfabetizmi funksional mbetet në shifra rekord. Në lexim, 1 në 2 fëmijë nuk e kupton atë që lexon. 50% e nxenesve nuk arrijne dot nivelin baze ne matematike, hasin veshtiresi ne lexim dhe ne zbatimin e njohurive ne shkence.Ne matematike dhe shkence Shqipëria eshte shume larg mesatares se OECD.

Ky është bilanci i një qeverie që ka prodhuar më shumë propagandë dhe jo arsim cilesor.

Pas një dekade pushtet, shqiptarët nuk kanë më nevojë për slogane, inaugurime fasadash apo projekte të emërtuara në anglisht. Kanë nevojë për shkolla, mësues, kapacitete, kurrikula që i afrohen tregut të punës, siguri dhe mbi të gjitha, për një arsim që u jep fëmijëve të tyre dijen dhe mundësinë për të ardhmen.

Investimi real dhe jo mashtrimi nis nga buxheti. Aktualisht, buxheti I arsimit eshte vetëm 2.29% të PBB, kur mesatarja europiane është 5%. Meuesit kane pagat me ulta ne Europe sipas OECD.

Arsimi duhet të financohet me të paktën 5% të PBB-së dhe pagat e të gjithë arsimtarëve duhet të dyfishohen, për t’u dhënë atyre dinjitetin, sigurinë dhe vlerësimin që meritojnë. Kjo ka qenë dhe mbetet bindja e Partisë së Lirisë.

Arsimi është për ne, një nga 5 Prioritetet Kombëtare për një Shqipëri më të fortë, më të zhvilluar dhe me 4 milionë shqiptarë plus!

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 14 Shtator11:53

[‘Corriere della Sera’: Protestat shndërrohen në lëvizje kundër qeverisë, kërkohet dorëheqja e Ramës](#)

Protestat kundër Edi Ramës kanë vazhduar për 106 ditë me radhë. Ndërkohë protesta e të shtunës shënoi n...

POLITIKE 14 Shtator08:00

[107-të protesta, diaspora bashkohet me mijëra qytetarë në shesh: Rama jep dorëheqjen](#)

Protestat kundër qeverisë vijojnë edhe këtë të hënë në Tiranë, ndërsa aksioni qytetar shënon ditë&e...

POLITIKE 13 Shtator21:47

[Vijon marshimi i protestuesve, thirrje njëzëri: Arrestoni Ballukun!](#)

Protesta kundër qeverisë vijon në rrugët e Tiranës, teksa qytetarët pjesëmarrës në ditën e 106-të t&eum...

POLITIKE 13 Shtator20:41

[Protesta/ Qytetarja denoncon: Persona nga Dubai po na marrin tokat, të shporret qeveria!](#)

Një qytetare që mori pjesë në protestë ka reaguar ashpër ndaj situatës në vend, duke ngritur shqetësime për ...

POLITIKE 13 Shtator20:39

[Berisha publikon denoncimin: Ryshfete dhe gjoba për emërime e grada në Policinë e Shtetit](#)

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka publikuar në rrjetet sociale një denoncim të ardhur nga një oficer i Policisë s...

POLITIKE 13 Shtator19:59

[Xhixho: Tirana pa ujë, qytetarët me bote, qyteti meriton ujë 24 orë, jo bote 24 orë! \(VIDEO\)](#)

Deputetja e Partisë së Lirisë, Erisa Xhixho, ka reaguar në rrjetet sociale për situatën e furnizimit me ujë në Tiran&e...

POLITIKE 13 Shtator18:47

[Rama flet për takimin në Berat: Kokëfortësia kolektive e Poliçanit i dha...](#)

Kryeministri Edi Rama përmes një postimi në "Facebook" ka ndarë pamje nga takimi i zhvilluar këtë të diele në...

POLITIKE 13 Shtator 17:14

["Do t'u bashkohemi protestave në Tiranë"/ Poliçani "kryqëzon" Ramën, debate të forta për Territorialet, banorët dhe kryebashkiaku braktisën sallën](#)

Detaje të reja janë zbuluar në lidhje me takimi e kryeministrit Rama me qytetarët në Berat u shoqërua me tensione dhe përpl...

POLITIKE 13 Shtator 15:13

[Pacolli akuzon zyrtarisht Ramën në Arbitrazh se po ja merr aeroportin për t'ia dhënë Ron Yeffetit](#)

Kompania Mabco e Behgjet Pacollit ka akuzuar zyrtarisht qeverinë shqiptare në Gjykatën e Arbitrazhit se po ja merr aeroportin e Vlorë...

POLITIKE 13 Shtator 13:52

["Qepeni gojën"/ Rama u pret fjalën banorëve të Poliçanit, debate me kryebashkiakun socialist dhe aktoren Egla Ceno](#)

Takimi i Kryeministrit Edi Rama në Berat lidhur me Reformën Territoriale është shoqëruar me tensione dhe debate të ashpra mes tij ...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

["Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

["Dil jashtë", u përplas me Edi Ramën për "Terri...](#)

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

AKTUALITET 13 Shtator

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...](#)


Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...


INVESTIGIME 31 Maj 14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video







Reagon Clevio!



Reagon Clevio!





Matilda, Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.